

Numri dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
<b>I</b>	<b>Politiko - Juridike.</b>		
I-1	Deklaratë e Bashkimit PAN - EPIRIOT në Amerikë, nëpërmjet së cilës kërkohet dhënien e Korçës dhe Gjirokastrës, Greqisë.	05.1919	24
I-2	Vendime të Qeverisë së Përkohëshme për emërimin e delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris, si dhe raporte dhe relacione mbi veprimtarinë e delegacionit.	02.14.1919 - 10.09.1919	20
I-3	Letra të popullit të Mallakastrës dhe Fierit, dërguar Parlamentit Italian dhe Qeverisë së Përkohshme të Durrësit, ku protestojnë kundër marrëveshjes Titori për okupimin e Gjirokastrës e Vlorës nga Greqia dhe Italia.	12.12.1919 - 12.18.1919	10
I-4	Letër e përfaqësuesve të Matit dërguar delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris, Kryekomandantit të Shqipërisë Vlorë, Delegacionit të Punëve të Brendshme Durrës dhe Ahmet Zogut, mbi protestën e popullit për çoptimin e tokave të Shqipërisë nga fuqitë e huaja.	03.17.1919 - 08.23.1919	8
I-5	Telegrame të Turhan Pashës dërguar Qeverisë Provizore, mbi propagandën Esadiste, veprimtarinë e Esad Pashës lidhur me Konferencën e Paqes në Paris, si dhe dërgimin e Mustafa Krujës në Paris në përbërjen e delegacionit shqiptar.	1919	3
I-6	"Miting i popullit të Lezhës mbi solidaritetin e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë", së Gjirokastrës shpallur nga forcat pushtuese italiane.	1919	2
I-7	Letër e Ekrem Libohovës dërguar Qeverisë së Durrësit mbi aktivitetin e tij në shtypin italian për mbrojtjen e të drejtave të Shqipërisë.	10.07.1919	2
I-8	Telegram i Matiolit ku uron për shkatërimin e Austrisë dhe lirinë e Shqipërisë.	11.12.1919 - 11.13.1919	3
I-9	Telegram i popullit të Leskovikut me të cilin përshëndet bashkimin e krahinës së Gjirokastrës me Qeverinë e Durrësit.	1919	3
I-10	Letër e komandantit të Gjindarmërisë në Korçë, dërguar komandantit të Gjindarmërisë në Berat mbi gjendjen e Korçës në prag të largimit të trupave franceze dhe përgënjeshtrimi i lajmeve për hyrjen e ushtrive greke në Korçë.	05.17.1919 - 10.01.1919	4

Numri dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
I-11	Telegram i Bumçit nga Roma ku njofton se ushtritë franceze do të vazhdojnë të qëndrojnë në Korçë dhe Pogradec, prandaj populli të moslargohet prej andej për mos me u lënë shesh intrigave greke.	09.30.1919	3
I-12	Telegram i ardhur nga Roma drejtuar ministrave me të cilën njofton mbi ardhjen e Alizotit.	09.25.1919 - 09.29.1919	3
I-13	Korrepondencë e kryetarisë së Qeverisë së Përkohshme drejtuar Kryemyftiut Tiranë mbi paraqitjen në Durrës, për të biseduar disa çështje të brendshme.	12.06.1919	1
I-14	Shkresë e Kryesisë së Qeverisë, e cila i drejtohet Prefekturës së Elbasanit, mbi sa të burgosur janë në Burgun e Elbasanit dhe pse janë burgosur.	1919	2
I-15	Procesverbal mbi sharjen dhe rrahjen e një gruaje nga një person për çështjen e një unaze dhe lutje e personit që është rrahur nga shërbëtori i hotelit.	07.23.1919 - 10.01.1919	4
I-16	Letër falenderimi e Qeverisë së Durrësit drejtuar Përfaqësisë Italiane, për përkrahjen që i jep shtypi italian Pavarësisë së Shqipërisë.	10.10.1919	2
I-17	Lutje e një personi që kërkon ndërhyrjen e Qeverisë me qëllim që ky të falet prej ushtrisë italiane.	12.28.1919	2
I-18	Korrespondencë mbi refuzimin e popullit, që krahina e Krumës të lidhet me krahinën e Durrësit.	01.30.1919	2
I-19	Korrespondencë e Prefekturës së Elbasanit me Ministrinë e Punëve të Brendshme mbi shkëputjen e krahinës së Çermenikës nga ajo e Mokrës dhe krijimi i saj si drejtori më vete.	04.19.1919 - 07.31.1919	8
I-20	Vendim dhe korrespondencë mbi organizimin e gjykatave në Shqipëri.	04.10.1919 - 12.13.1919	5
I-21	Korrespondencë mbi organizimin e zyrave.	03.29.1919	2
I-22	Telegram i Myfit Libohovës dërguar Kryeministrit të cilit i uron emërimin e tij.	07.15.1919	1
I-23	Njoftim mbi thirrjen e një mbledhje për zgjedhjen e një pleqësie.	04.17.1919	2

Numri dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
I-24	Korrespondencë e Prefekturës së Durrësit me Ministrinë e Punëve të Brendshme mbi të drejtat e të zgjedhurit të muhaxhirëve të ikur nga armiku.	09.24.1919	2
I-25	Listë, korrespondencë etj., mbi emërime të kuadrit në përgjithësi.	02.06.1919 - 11.24.1919	6
I-26	Qarkore, lutje, korrespondencë etj., mbi emërim, transferim dhe pushim të kuadrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.	01.18.1919 - 02.19.1920	43
I-27	Lutje dhe korrespondencë mbi emërim, transferim dhe pushim të kuadrit të Ministrisë së Drejtësisë.	01.18.1919 - 01.21.1920	28
I-28	Listë organike e Drejtorisë së Përgjithshme të Postë - Telegrafave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Pensioneve Civile.	1919	1
I-29	Kryesia e Shoqërisë " Vatra " në Boston kërkon dhënien e lejes Fan Nolit për të hyrë në Shqipëri dhe emërimin e tij delegat pranë Lidhjes së Kombeve, Zvicër. Lajmërohet ardhja e At-Nolit me vaporin Puglia.	07.03.1920 - 11.03.1920	10
I-30	Letër drejtuar Kryetarit të Qeverisë Shqiptare nga Mitropoliti i Durrësit kundër ardhjes së Fan Nolit në Shqipëri nga Amerika si Episkop.	07.22.1920	1
I-31	Korrespondencë me Koloninë Shqiptare në Kostandinopol mbi disa pretendime të tyre.	1920	1
I-32	Shoqëria Shqiptare " Dëshira " e Sofjes uron Qeverinë e re dhe kërkojnë të kenë një përfaqësues në Qeverinë Shqiptare.	04.25.1921	3
I-33	Komiteti i Kolonisë Shqiptare në Turqi shfaq përgëzimet për sukseset e arritura dhe shfaqin besnikërinë ndaj Qeverisë Kombëtare, ndërkohë dhe ngrejnë disa probleme që i prokupojnë.	12.28.1920	5
I-34	Vendim mbi bandën muzikore të shoqërisë " Vatra " për t'u bërë bandë kombëtare.	09.14.1920	2
I-35	Përfaqësuesi shqiptar Eqerem Libohova kërkon mendimin e Qeverisë se do ta ndihmojë dhe përkrahë formimin e një shoqërie patriotike në Romë.	06.16.1919	2

Numri dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
I-1844	Njoftim i të dërguarit italian togerit Rika bërë Kryetarit të Qeverisë Provizore të Durrësit, mbi kthimin e forcave popullore dhe të gjindarmërisë nga Kurbini me fitore, rrethi i Krujës është me qeverinë dhe Hamit Bej Toptani ka mbledhur kryepaqësorinë në Sukth.	01.18.1919	2
I-1845	Korrespondencë e qeverisë provizore mbi gjendjen në Shqipëri, mbi pretendimet greke për Korçën dhe Gjirokastrën, deklarata e Presidentit Klemanso në lidhje me pushtimin francez të Korçës etj.	01.08.1919 - 12.10.1919	8
I-1846	Njoftim mbi situatën politike në rrethin e Krujës dhe ngarkimin e Mustafa Krujës për vendosjen e rregullit dhe të qetësisë në këtë rreth.	12.17.1919	1
I-1847	Letër (që nuk dihet se kush e dërgon) drejtuar Turhan Pashës Kryetarit të Qeverisë Shqiptare që ndodhet në Paris, mbi masat që janë marrë për zhdukjen e dallimit ndërmjet krishterëve dhe myslimanëve të Shqipërisë së Jugut.	03.20.1919	1
I-1848	Protestë e klerikëve myslimanë e katolikë dhe parisë të dy besimeve për makinacionet e rretheve të huaja që janë të interesuar për përçarjen e Shqipërisë të cilët nxisin popullsinë që të shprehet për një internacionalizëm të krahinës së Shkodrës dhe shprehje e vullnetit për t'u bashkuar me pjesën tjetër të Shqipërisë një dhe e pandarë.	1919	2
I-1849	Protestë e komandës së trupave italiane në Shqipëri, qeverisë provizore, kundër një qarkoreje të qeverisë provizore drejtuar autoriteteve vartëse ku këto ftohen për të denoncuar në popull marrëveshjet midis Italisë e Greqisë në dëm të Shqipërisë, komanda e përgënjeshtrore e shpreh keqardhje.	10.02.1919	1
I-1850	Njoftim për nisjen nga Selaniku të emisarëve të Esat Pashës për të bërë propagandë në krahinën e Shkodrës, emisarët serbo-esadist duan të bëjnë për vete parinë duke u bërë premtime dhe dërgon telegrame proteste delegacioneve të antantës në Konferencën e Paqes.	04.10.1919	5
I-1851	Telegram nga qyteti i Korçës drejtuar Qeverisë Provizore të Durrësit ku kërkojnë udhëzime se si të punojnë, për të mirën e vendit duke patur parasysh pushtimin e qytetit të tyre nga francezët.	1919	1

Numri dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
I-1852	Relacion i anëtarëve të komisionit të krahinës së Vlorës drejtuar qeverisë, mbi gjendjen politike në krahinën e Vlorës.	11.03.1919	2
I-1853	Njoftime në lidhje me situatën politike në krahinën e Durrësit dhe solidarizimin e tyre me qeverinë e re.	07.15.1919	1
I-1854	Falenderime të Qeverisë Shqiptare drejtuar një generali të huaj në Shqipëri, për ndihmën që i kanë dhënë qeverisë si dhe harmonia që duhet të ekzistojë ndërmjet qeverisë dhe autoriteteve ushtarake të okupacionit.	1919	1
I-1855	Njoftim i Nënkrjetarit të Qeverisë Provizore Mehdi Frashëri drejtuar Delegacisë së postë-telegrafave në Durrës, mbi marrëdhëniet e qeverisë me autoritetet e vendit dhe Komandën e Lartë të Fuqive Armate.	03.20.1919	1
I-1856	Njoftim i Turhan Pashës për marrjen e letrës të dërguar nga kryetari i Qeverisë Provizore i cili premtun se do të verë të gjitha forcat për realizimin e detyrës së ngarkuar.	1919	1
I-1857	Urdhëresë e Qeverisë Provizore drejtuar Delegacisë së Punëve të Brendshme mbi zgjedhjen e dërgimin nga çdo prefekturë të përfaqësuesve të pleqësive dhe përfaqësuesit do të jenë myslimanë e i krishterë.	09.22.1919	1
I-1858	Shkresë e Mustafa Krujës drejtuar kryetarit të Qeverisë në Durrës, mbi shqyrtimin e ankesave të popullit si dhe detyrat, kompetencat dhe korrektesën e nëpunësve të shtetit.	08.29.1919	1
I-1859	Lutje e një personi drejtuar zëvendëskryetarit të Qeverisë Provizore, për emërim në punë.	03.13.1919	1
I-1860	Njoftim që i bëhet Gjergj Fishtës për emërimin e tij si inspektor në delegacinë shqiptare.	02.28.1919	1
I-2121	Urime dërguar Sulejman Bej Delvinës si deputet i Gjirokastrës për hapjen e parë të Parlamentit Shqiptar.	1919	1
I-2142	Libri i vendimeve të Këshillit të Qeverisë Provizore të Durrësit.	1919 - 1919	150
I-2143	Libri i vendimeve të Këshillit të Qeverisë Provizore të Durrësit.	1919 - 1919	213
<b>II</b>	<b>Ushtarake.</b>		
II-1	Korrespondencë, mbi emërime, transferime dhe pushime të kuadrit ushtarak.	04.30.1919 - 12.15.1919	9

<b>Numri dosjeve</b>	<b>Titulli</b>	<b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b>	<b>Sasia e fletëve</b>
II-2	Korrespondencë me Ministrinë e Punëve të Brendshme, mbi dërgimin jashtë shtetit të disa nxënësve për të përgatitur kuadro për ushtrinë.	03.31.1919	1
II-3	Fonogramë, mbi kërkimin e një statistike nga Qeveria e Përkohshme, mbi kuajtë e oficerëve të Gjindarmërisë (statistika mungon).	08.21.1919	3
II-4	Korrespondencë e Gjindarmërisë, drejtuar Qeverisë mbi uniformën e oficerëve dhe gjindarmëve.	05.09.1919	2
II-5	Lutje e disa oficerëve me qëllim që të bashkohen, që janë shpërndarë nëpër Shqipëri dhe të sigurohet jeta e tyre.	04.24.1919	2
II-6	Korrespondencë midis Delegacisë së Punëve të Brendshme, mbi emërimin e një mjeku në Shkollën e Gjindarmërisë.	04.24.1919	2
II-7	Korrespondencë, mbi emërimin e kuadrit të Gjindarmërisë.	01.18.1919 - 05.20.1919	4
II-8	Korrespondencë midis Prefekturës së Durrësit dhe Delegacisë së Punëve të Brendshme, mbi nevojën e shtimit të forcave të Gjindarmërisë për garantimin e qetësisë.	03.13.1919	2
II-9	Rregullore mbi detyrat, marrëdhëniet dhe kompetencat e Karabinerisë-Gjindarmërisë.	08.17.1919	8
II-10	Korrespondencë e situacione, mbi ndihmën që ka dhënë populli i Korçës në aksione me Major Tatzatin në krye.	10.04.1919 - 12.09.1919	10
II-11	Lutje e një personi, i cili kërkon të shpërblehet dëmi i bërë nga ushtritë e huaja.	02.18.1919	3
II-12	Lutje e personave të ndryshëm, drejtuar Qeverisë së Përkohshme ku kërkojnë lirimin e lokaleve të okupuara nga ushtritë italiane dhe pagimin e qirave të tyre.	04.22.1919 - 10.24.1919	14
II-13	Lutje banorve të qytetit të Durrësit drejtuar Kreministrisë mbi pagimin e dëmeve të bëra nga ushtria italiane disa personave.	05.13.1919	5
II-14	Lutje e disa personave, mbi uljen e dëmeve që u bëri ushtria austro-hungareze duke i marrë 150 qese misër.	12.05.1919	3
II-119	Shkresë, dërguar Ministrisë së Drejtësisë, mbi ankimin e disa personave kundrejt një kapteri të gjindarmarisë.	02.23.1919	1
II-464	Kërkesë e një koloneli italian të hyjë në shërbim të ushtrisë shqiptare dhe kërkon të dijë datën e fillimit në detyrë.	05.13.1919	4

Numri dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
III	<b>Ekonomi - Financë.</b>		
III-1	Kërkesë e disa personave për dhënie ndihme. Koncesionet dhe firmat e huaja në Shqipëri dhe specialistë e huaj.	07.14.1919 - 07.16.1919	2
III-2	Relacion për ngritjen e një koncesioni duhani.	12.07.1919 - 12.07.1919	2
III-3	Lutje të një personi i cili kërkon transferim që të ndërrojë klimën për arsye shëndetësore (ky është kuadër në blegtori).	12.25.1919	1
III-4	Listë, korrespondencë e Ministrisë së Punëve Botore drejtuar Qeverisë mbi emërimin e kuadrit të ndërtimit.	01.18.1919 - 09.25.1919	5
III-5	Telegram i Eqerem Libohovës mbi bisedimet me palën italiane për pavarësinë e punimeve botore shqiptare.	10.05.1919 - 10.05.1919	2
III-6	Korrespondencë mbi emërimin e kuadrit të tregtisë.	10.08.1919 - 10.11.1919	2
III-7	Vendimi i Këshillit Qeveritar mbi emërim kuadri doganor.	03.04.1919 - 05.08.1919	2
III-8	Lutje e tregtarëve të Durrësit, të cilët kërkojnë që të merren masa kundër nëpunësve të doganave që i kryejnë detyrat sipas interesit të tyre.	08.13.1919 - 08.13.1919	2
III-9	Korrespondencë e Ministrisë së Financave me Kryesinë e Qeverisë mbi moslënien shkak me kërkue dame nga qeveria, të zgjatet afati i dorëzimit në Gjirokastër.	02.26.1919 - 02.26.1919	1
III-10	Korrespondencë e Ministrisë së Financave drejtuar qeverisë mbi taksat që u merren tregtarëve për mallrat që transportohen.	12.01.1919 - 12.01.1919	1
III-11	Korrespondencë e zyrës së doganës me Ministrinë e Financave mbi taksën e marrë nga Shkodra për së dyti.	03.29.1919 - 04.02.1919	2
III-12	Lutje e tregtarëve të Durrësit mbi heqjen e taksën doganore.	09.02.1919 - 10.03.1919	4
III-13	Qarkore mbi doganat.	05.19.1919 - 01.12.1922	86
III-14	Lutje e një personi i cili kërkon leje për nxjerrjen jashtë shtetit të 150.000 kg. misër.	02.24.1919	2
III-15	Korrespondencë mbi lejen që kërkojnë disa persona për eksportim kafshësh.	07.01.1919 - 10.30.1919	5

Numri dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
III-16	Vendim i Këshillit të Ministrave mbi mosdaljen e kuajve jashtë shtetit dhe lutje e disa personave që kërkojnë të çojnë kuaj në Itali.	05.16.1919 - 08.16.1919	8
III-17	Korrespondencë mbi ngritjen e çmimit të kripës.	01.22.1919	2
III-18	Korrespondencë mbi uljen e çmimit të misrit.	02.09.1919	2
III-19	Korrespondencë mbi emërime kuadrit të Postë Telegraf Telefonave.	03.13.1919 - 07.23.1919	3
III-20	Korrespondencë mbi delegatët e Postë Telegraf Telefonave.	10.18.1919	1
III-21	Protokolle, korrespondencë etj. mbi krijimin e një komisioni për të zgjedhur pullat e postës.	07.31.1919 - 02.12.1921	7
III-22	Korrespondencë mbi shtypjen e pullave me fortesën e Krujës jashtë shtetit.	05.08.1919	1
III-23	Vendim i Këshillit të Delegatësisë mbi taksën e letrave.	02.05.1919	1
III-24	Korrespondencë mbi ndryshimin e çmimit të pullave në rastin e ndryshimit të taksës së tyre.	05.13.1919	1
III-25	Korrespondencë mbi çmimin e letrave të postuara.	02.05.1919	1
III-26	Korrespondencë mbi pengesën që sjellin zyrat e postave në lidhje me postimin e librave.	05.08.1919 - 05.15.1919	1
III-27	Korrespondencë mbi emërime të kuadrit të Ministrisë së Financave.	01.20.1919 - 09.26.1919	4
III-28	Korrespondencë e Qeverisë me Ministrinë e Punëve Botore mbi sasinë e kapitalit që kanë prefekturat dhe dokumentet t'i dërgohen zyrës së financës.	03.31.1919 - 04.29.1919	2
III-29	Korrespondencë dhe lista mbi komunikimin e vendimeve të marra në lidhje me projektbuxhetin mujor, si dhe lista pullash.	02.03.1919 - 05.08.1919	25
III-30	Lutje të një personi drejtuar Ministrisë së Drejtësisë mbi dëftesën e buxhetit që ka patur vëllai i Asllan Belegut.	04.12.1919	1
III-31	Korrespondencë mbi ndalimin e daljes jashtë shtetit të arit dhe argjendit si dhe zhdukja e sermit.	10.05.1919 - 01.31.1920	4
III-32	Korrespondencë e Ministrisë së Financave drejtuar gjithë financave mbi kursin e të hollave si dhe një listë.	05.17.1919 - 10.13.1919	2
III-33	Korrespondencë e Gjyqit të Lartë të Shën'Atit me Kryesinë e Qeverisë mbi mosshkruarjen më të koronave letër të Austrisë, gjyqi vendosi që Musa Mazi të paguajë shumën e marrë.	11.09.1919	1

Numri dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
III-34	Korrespondencë mbi pagim mbledhje dhe pranim të dhjetash.	05.14.1919 - 07.23.1919	10
III-35	Korrespondencë mbi pranimin e rregullores së vergjisë në qytetin e Shkodrës.	04.03.1919	1
III-36	Korrespondencë e Postë Telegraf Telefonave drejtuar qeverisë mbi marrje takse për letër arnare.	07.07.1919 - 07.08.1919	1
III-37	Korrespondencë, etj. mbi shpenzimet e bëra për shpërblime, prerje, pagim, shtim rroge.	01.18.1919 - 01.22.1920	71
III-38	Korrespondencë mbi shpenzimet për delegatët e qeverisë prej një shume 19.271 franga ari.	01.20.1919	1
III-39	Korrespondencë mbi shpenzimet e bëra për delegatët që kanë qenë në mbledhje.	01.20.1919 - 07.07.1919	4
III-40	Korrespondencë mbi shpenzimet e udhëtimit dhe dietat.	03.01.1919 - 12.10.1919	7
III-41	Korrespondencë mbi shpenzimet e bëra për paradhënie.	02.03.1919	2
III-42	Korrespondencë e Qeverisë me Ministrinë e Financave mbi pensionin e nëpunësve.	01.29.1919 - 03.19.1919	2
III-43	Korrespondencë mbi pagimin e 200 lekëve për shpenzime të jashtëzakonshme.	04.26.1919	1
III-44	Korrespondencë e Qeverisë me Ministrinë e Financave mbi shpenzimet e bëra me rastin e drekës dhe darkës që bëhet për banorët e Pukës dhe Mirditës.	08.18.1919	2
III-45	Korrespondencë mbi shpenzimet e bëra për oficerët e xhandarmërisë që do të vijnë në shkollën e Tiranës.	07.12.1919	3
III-46	Korrespondencë mbi shpenzimet e bëra për veshjen e oficerëve.	07.14.1919	1
III-47	Korrespondencë mbi shpenzimet e bëra për meremetimin e xhamisë së Elbasanit.	04.24.1919 - 10.31.1919	5
III-48	Korrespondencë mbi shpenzimet e bëra për blerje regjistrash.	05.05.1919	2
III-49	Korrespondencë mbi shpenzimet e bëra për mobilim zyrash.	04.01.1919	1
III-50	Korrespondencë mbi një fond për të blerë kancelari.	04.01.1919 - 04.22.1919	2
III-51	Korrespondencë mbi shpenzimet e bëra për punimin e një harte gjeografike.	s.d.	0

Numri dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
III-52	Korrespondencë mbi kërkesa qiraje për truall.	12.24.1919 - 01.18.1920	4
III-53	Korrespondencë mbi pagesë qiraje të dhomave të gjyqit fakëfëvet etj.	03.30.1919 - 09.20.1919	11
III-54	Korrespondencë e Gjyqit të Lartë të Shën 'Atit me Qeverinë mbi hetimet e Naibit të Durrësit, të dërguar personave të tjerë që të mos bëjnë shpenzime të tjera.	03.05.1919 - 03.25.1919	1
III-55	Lutje e disa personave mbi sekuestrimin e tre dyqaneve që i detyrohen Agush Garbajt për padrejtësinë që i bëhet nga Gjykata e Lushnjës.	12.28.1919	4
III-56	Lutje e Isuf Elezit nga Tirana mbi anulimin e vendimit për shitjen e magazinës në Nënprefekturën e Durrësit.	10.11.1919	2
III-57	Korrespondencë mbi trashëgiminë.	11.27.1919	1
III-58	Lutje mbi pasurinë që përfaqëson një person.	03.03.1919	1
III-3848	Relacion i inxhinierit Eshref Frashëri drejtuar qeverisë mbi divergjencat që ka me Ministrinë e Punëve Botore, Sami Vrioni, i cili do ta pushojë dhe nga puna.	12.11.1919	2
III-3849	Njoftim i Prefekturës së Elbasanit mbi emërimin e një nëpunësi në Bankën e Bujqësisë në Peqin si dhe të dhëna mbi një nëpunës finance.	12.01.1919	5
III-3850	Shkresë e dy qytetarëve italianë drejtuar Kryesisë së Qeverisë Provizore Shqiptare në Durrës, të cilët kërkojnë autorizimin për të marrë me qira liqenin e Butrintos e kanal in hyrës në liqen me qëllim peshkimi.	09.28.1919	2
III-3851	Fjalimi i mbajtur nga sekretari i Bashkisë së Shijakut me rastin e inaugurimit të urës mbi lumin Erzen.	02.23.1919	2
III-3852	Shkresë përcjellëse e letrës së kapitenarisë së portit në Vlorë lidhur me " Linjën " e lundrimit të Adriatikut të poshtëm dhe kopje e tarifës të shoqërisë " Pugli " .	07.05.1919 - 07.18.1919	4
III-3853	Shkresë drejtuar qeverisë provizore ku kërkohet ndërhyrja, për të mos penguar veprimin e postave në shpërndarjen e letrave.	03.19.1919	1
III-3854	Lutje drejtuar qeverisë për akordimin e lejeve për transportim malli.	09.30.1919 - 10.01.1919	2

<b>Numri dosjeve</b>	<b>Titulli</b>	<b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b>	<b>Sasia e fletëve</b>
III-3855	Lutje drejtuar qeverisë ku kërkon të mos i merret taksë për shitjen e kripës.	02.01.1919 - 09.09.1919	3
III-3856	Shkresë e komandës të trupave italiane drejtuar Qeverisë Provizore Shqiptare në Durrës mbi pagesën e rrogave të gjindarmëve nga ana e qeverisë shqiptare.	10.03.1919	1
III-3857	Shkresë e Komisarariatit të Lartë Italian drejtuar Kryesisë së Qeverisë Provizore të Durrësit, për përcjelljen e lutjes së firmës " Manushi " nga Berati, që kërkon ti paguhen disa mallra që iu rekuizuan nga ushtria austriake.	08.16.1919 - 10.31.1919	3
III-3858	Relacion i Fejzi Alizotit drejtuar kryetarit të Qeverisë së Durrësit mbi nxjerrjen e arit jashtë shtetit nga tregtarët dhe marrjen e masave për evitimin e kësaj gjendjeje.	10.17.1919	2
<b>IV</b>	<b>Arsim - Kulturë.</b>		
IV-1	Listë, lutje, korrespondencë etj., mbi emërime dhe transferime të kuadrit arsimor.	01.28.1919 - 12.29.1919	13
IV-2	Lutje e disa mësuesve, të cilët kërkojnë leje për të pushuar për arsye shëndetësore dhe të zëvendësohen me të tjerë.	08.04.1919 - 08.05.1919	4
IV-3	Memorandum mbi problemet arsimore që duhen ndjekur.	01.29.1919 - 01.30.1919	2
IV-4	Lutje e Komisionit të Arsimit të Prefekturës së Durrësit mbi hapjen e shkollave për fëmijët e Durrësit.	02.09.1919	2
IV-5	Telegram i Eqerem Libohovës mbi studentët universitarë, që heqin keq për të jetuar dhe kthim i disave në Shqipëri.	02.16.1919 - 09.27.1919	3
IV-6	Lista, korrespondencë etj., studentësh shqiptarë që kërkojnë bursë prej qeverisë dhe që njoftojnë se filluan shkollën.	08.04.1919 - 12.31.1919	16
IV-7	Korrespondencë mbi studentët shqiptarë që studiojnë jashtë shtetit, si dhe një listë studentësh shkodranë.	10.20.1919	3
IV-8	Korrespondencë mbi rregullimin e Medresesë për të filluar mësimin.	04.23.1919	1
IV-9	Korrespondencë e Gjyqit të Lartë të Sheriatit me Kryesinë e Qeverisë Shqiptare në Durrës mbi dhënie koronash me interes Medresesë së Peqinit.	02.18.1919 - 04.01.1919	4

<b>Numri dosjeve</b>	<b>Titulli</b>	<b>Viti (Filluar-Mbaruar)</b>	<b>Sasia e fletëve</b>
IV-605	Njoftim i Bashkisë së Vlorës dërguar Kryeministrisë në Tiranë mbi formimin e një bande muzikore prej 40 vetash, të cilët duhet të jenë të përjashtuar nga shërbimi ushtarak.	1919	1
VI	Civile - Administrative.		
VI-1	Korrespondencë mbi dhënie pasaportash.	10.01.1919	2
VI-2	Letër e Mark Gjonit dërguar Qeverisë së Përkohshme ku falenderon për ngushëllimet e bëra për vdekjen e Preng Bibdodës.	03.30.1919	1
VI-3	Lutje e një personi i cili kërkon riatdhesim, se po vuan për të ngënë.	12.14.1919	1
VI-4	Listë dhe korrespondencë mbi kërkimin e përfundimit të disa akteve.	10.28.1919 - 12.29.1919	5
VI-5	Listë mbi dërgimin e shkresave të qeverisë.	1919	9
VI-6	Korrespondencë e Prefekturës së Elbasanit me Ministrinë e Punëve të Brendshme mbi paraqitjen e një model akti të shtetit civil.	05.10.1919 - 05.25.1919	2
VI-7	Korrespondencë mbi emërim, transferim etj. të kuadrit fetar.	01.26.1919 - 11.26.1919	10
VI-740	Kërkesë e një kleriku drejtuar Kryeministrisë, mbi klasifikimin e nëpunësve të zyrave fetare si ato të administratës shtetërore.	12.01.1919	1
<b>V</b>	<b>Shëndetësia.</b>		
V-1	Lutje e farmacistit Herezegl dhe vëllezërit mbi pagesën e ilaçeve që kanë dhënë për të sëmurët.	07.15.1919	1